



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

---

**URDHËR**

**Nr. 84 datë 16 .04.2010**

**Për shpërblimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore**

*Me synimin*, stimulimin e punës me cilësi dhe profesionalizëm, të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

*Në mbështetje*, të nenit 8, pika 2, germa “gj” të ligjit Nr. 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë":

**URDHËROJ:**

**1.** Drejtuesit e prokurorive të të gjitha hallkave të Prokurorisë dhe drejtorët në Prokurorinë e Përgjithshme, për të vlerësuar meritat profesionale të prokurorëve, duhet të marrin në konsideratë këto kriterë;

- Komplexitetin dhe vështirësinë e procedimeve penale në hetimet paraprake dhe në përfaqësimin e akuzës në gjykatë;
- Cilësinë e lartë të akteve procedurale gjatë hetimeve paraprake ose diskutimet përfundimtare, me të cilat prokurori argumenton dhe mbron kërkesat e tij gjatë seancave gjyqësore;
- Ushtrimin e ndjekjes penale brenda një afati ligjor dhe të arsyeshëm të procedimeve penale ;
- Volumin e punës të kryer në hetimet paraprake, në ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykim;

- Qendrimin aktiv dhe profesional të prokurorit në seancat gjyqësore.
- Volumin e punës të kryer në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit;
- Zgjidhjen ligjore cilësore përfundimtare të çështjeve në hetimet paraprake;
- Organizimin dhe kontrollin e ndjekjes penale që në momentin e marrjes së një kallëzimi penal apo referimin e veprës penale nga policia gjyqësore deri në zgjidhjen ligjore përfundimtare të proçedimit penal;
- Drejtimi, ndihma dhe kontrolli i veprimtarisë së oficerit apo agjentit të policisë gjyqësore të ngarkuar prej tij, për kryerjen e veprimeve hetimore paraprake ose veprimeve të tjera proçedurale.
- Pjesëmarrjen aktive në aktivitetet profesionale që kryhen me prokurorë, oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore, duke identifikuar drejt problematikën dhe duke e trajtuar atë në mënyrë të efektshme;
- Punimet juridike që kanë vlera shkencore dhe profesionale në punën e prokurorit;
- Organizimi i veprimeve të nevojshme proçedurale apo administrative, në prokurori dhe në policinë gjyqësore, duke planifikuar qartë veprimet që do të kryhen dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale;

2. Drejtuesit e prokurorive të të gjitha hallkave të Prokurorisë dhe drejtorët në Prokurorinë e Përgjithshme, për të vlerësuar meritat profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore, duhet të marrin në konsideratë këto kritere;

- Kompleksitetin, vështirësinë dhe përkushtimin në hetimet paraprake:
- Cilësinë e lartë të akteve proçedurale gjatë kryerjes së veprimeve hetimore:
- Volumin e punës të kryer në hetimet paraprake:
- Volumin e punës të kryer në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit:
- Organizimi dhe kontrolli i ndjekjes penale që në momentin e marrjes së një kallëzimi penal apo referimi të veprës penale nga policia gjyqësore deri në zgjidhjen ligjore përfundimtare të proçedimit penal:
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet profesionale që kryhen duke identifikuar drejt problematikën dhe duke e trajtuar atë në mënyrë të efektshme:

- Punimet juridike që kanë vlera shkencore dhe profesionale në punën e oficerit të policisë gjyqësore:
3. Nuk përfitojnë nga marrja e shpërblimeve prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të cilat kanë në fuqi masa disiplinore.
  4. Drejtuesi i Prokurorisë dhe drejtori në Prokurorinë e Përgjithshme , pas dhënies së shpërblimit nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, komunikon në mbledhjen e kolektivit, emrin e prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, meritat profesionale për të cilat i është dhënë shpërblimi.
  5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtuesit e të gjithë hallkave, drejtorët në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore.
  6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**INA RAMA**